

924 13.9.23



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

3619
Nr. Prot

Peshkopi, më 12.09.2023

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.96

Datë: 07.09.2023

“Për miratimin e Projektit “Discover Dibër and Debar.”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak



Adresa: Bulevardi “Elez Isufi” Peshkopi, email: bashkiadiber@gmail.com tel: 003552/822935

Kepyo



3619/15/09/23
Miratimi D

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.924/1.prot.

Peshkopi, më 13.09.2023

Lënda : Per vendimin nr. 96, datë 07.09.2023 të Këshillit të Bashkisë Dibër

BASHKISE DIBER

PESHKOPI

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.96, datë 07.09.2023 "Per miratimin e Projektit "Discover Dibër and Debar", duke marrë në konsideratë karakteristikat e aktit administrativ objekt shqyrtimi, vendosa :

Miratimin në parim të aktit administrativ objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën kontraktore dhe respektimit të ligjit "për traktatet dhe marrëveshjet ndërkombëtare", veprime që kurdoherë janë përgjegjësi direkte administrativo-ligjore e strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër që kanë paraqitur për miratim projekt aktin dhe relacionin shpjegues mbi bazën e të cilit ka dalë vendimi i ardhur pranë nesh për verifikim ligjshmërie.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 96 Datë 07 / 09 / 2023

“Për miratimin e Projektit “Discover Dibër and Debar”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “ Për vetëqeverisjen Vendore, si dhe Planin Strategjik të Turizmit (2018-2028)., Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **07.09.2023**, me 18 vota pro, 0 kundër dhe 4 apstenim:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Discover Dibër and Debar” të financuar nga USAID, me një vlerë 25.000\$.
2. Bazuar në marrëveshjen Standarte të lidhur midis Bashkisë Dibër, Shqipëri dhe Komunës Debar, Republika e Maqedonisë së Veriut, ne datën 27.03.2023, shuma prej 11,130 \$ do të administrohet nga Bashkia Dibër ndërsa pjesa tjetër prej 14,080\$ nga Komuna Debar.
3. Bazuar në Marrëveshjen Standarte të lidhur midis këtyre institucioneve për këtë projekt ndërkufitar, Bashkia Dibër (si partner në këtë projekt), duhet të realizoj aktivitetet e planifikuara dhe pasi ato të jenë raportuar tek donatori ti drejtohet Komunës Debar (si drejtuese e projektit në këtë rast) për arkëtimin e shpenzimeve.
4. Bashkia Dibër duhet të marrë angazhimin që për implementimin e projektit të angazhojë burimet njerëzore aktuale në fushat përkatëse në periudhën e ardhshme 8-mujore të implementimit të projektit si bashkëfinancim me një vlerë 5,400\$.
5. Në zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Shërbimit Turizmit, Struktura e Integritimit Evropian dhe Ndihmës së Huaj, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Teritorrit dhe Drejtoria Ekonomike, pranë Bashkisë Dibër.
6. Vendimi hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
7. Vendimi u shpall me datë **07.09.2023**.

Kryetare e Këshillit Bashkiak

Irfan Shehu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
STRUKTURA E INTEGRIMIT DHE NDIHMËS TË HUAJ

PROJEKT - VENDIM
Nr. 23, Date 01 / 09 / 2023
Për miratimin e Projektit:

"Discover Dibër and Debar"

Në mbështetje të ligjit nr 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", si dhe Planin Strategjik të Turizmit (2018-2028),

Kërkojmë:

1. Miratimin e projektit "Discover Dibër and Debar" të financuar nga USAID, me një vlerë 25,000 \$.
2. Bazuar në Marrëveshjen Standarde të lidhur midis Bashkisë Dibër, Shqipëri dhe Komunës Debar, Republika e Maqedonisë të Veriut, në datën 27.03.2023, shuma prej 11,130 \$ do të administrohet nga Bashkia Dibër ndërsa pjesa tjetër prej 14,080\$ nga Komuna Debar.
3. Bazuar në Marrëveshjen Standarde të lidhur midis këtyre institucioneve për këtë projekt ndërkufitar, Bashkia Dibër (si partner në këtë projekt) duhet që të realizoj aktivitetet e planifikuara dhe pasi ato të jenë raportuar tek donatori ti drejtohet Komunës Debar (si drejtuese e projektit në këtë rast) për arkëtimin e shpenzimeve.
4. Bashkia Dibër duhet të marrë angazhimin që për implementimin e projektit të angazhojë burimet njerëzore aktuale në fushat përkatëse në periudhën e ardhshme 8-mujore të implementimit të projektit si bashkëfinancim me një vlerë 5,400 \$.
5. Në zbatim të këtij vendimi ngarkohet Sektori i Shërbimit Turizmit, Struktura e Integrimit Evropian dhe Ndihmës të Huaj, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Teritorrit dhe Drejtoria Ekonomike.

Për Bashkinë Dibër:

Drejtori i Planifikimit
dhe Zhvillimit të Teritorrit
z. Elvis MANGA

Struktura e Integrimit Evropian
dhe Ndihmës të Huaj
z. Ardit VRANIÇI

Drejtoria Ekonomike
z. Mensur SHEHI

Drejtori Juridik
z. Ismet SARAÇI

KRYETARI I BASHKISË
Rahim SPAHIU